3150/3
16.11.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MIRËQENIEN SOCIALE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 5308/1 Prot. Tiranë, më 13.11 2026

Lënda: Kthim përgjigje mbi ftesën për konsultim dhe paraqitje komentesh për "Kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë".

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
Adresa: "Irfan Tomini", Njësia administrative Nr. 7, Tiranë

Për dijeni: **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit". nr. 1. Tiranë

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SH.A.
Autostrada Tiranë–Durrës, km 9, Yrshek, Kashar, Tiranë

OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SH.A.
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 88, H.1, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A.
Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa nr. 88, H.1, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 3150/1 prot., datë 03.11.2026, protokolluar me tonën me nr. 5308 prot., datë 05.11.2026, me lëndë "Ftesë për konsultim dhe paraqitje komentesh mbi 'Kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë'", ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale vlerëson qëllimin e projekt-rregullores për garantimin e mbrojtjes së veçantë të klientëve në nevojë lidhur me ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.

Në lidhje me nenin 4 të projekt-rregullores, sugjerojmë qartësimin e procedurës së regjistrimit dhe çregjistrimit, në përputhje me ndarjen e përgjegjësive të përcaktuar në nenin 118, pikat 4, 9 dhe 10, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike". Konkretisht, regjistrat e administruar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi duhet të mbështeten në informacionin e përcjellë nga strukturat përgjegjëse, sipas parashikimeve ligjore.

Në kuadër të fushës së përgjegjësisë së MSHMS-së, sistemet elektronike të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror përmbajnë të dhëna për përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike dhe të pagesave të aftësisë së kufizuar. Për këto kategori, propozojmë të parashikohet mundësia e ndërveprimit të sistemeve elektronike me sistemet përkatëse të OSSH-së dhe të furnizuesit, me qëllim verifikimin e statusit të përfituesit dhe përditësimin e informacionit.

Përfitimi nga skemat e sipërpërmendura do të shërbejë si informacion për verifikimin e kritereve përkatëse, ndërsa njohja e statusit "klient në nevojë" duhet të kryhet sipas kritereve dhe procedurave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 118 të ligjit.

Gjithashtu, sugjerojmë harmonizimin e nenit 9, pika 3, me nenin 5, pika 6, shkronja "b", duke përcaktuar shprehimisht se furnizimi nuk ndërpritet gjatë shqyrtimit të ankesës lidhur me detyrimin që përbën shkak për ndërprerjen. Sugjerojmë edhe përcaktimin e një afati minimal pas marrjes së njoftimit përfundimtar, konkretizimin e përshtatjes së planeve të pagesës me mundësitë ekonomike të familjes dhe qartësimin e procedurës së dokumentimit të rasteve që përdorin pajisje për mbështetjen e jetës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Enea HOTI